



Në bazë të nenit 68 paragrafi 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, sipas nenit 26 pika 9 dhe nenit 74 të Statutit të Komunës së Deçanit, bazuar në nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.31.05.2021, bie këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E GRUPEVE PUNUESE PËR ORGANIZIMIN E DEBATEVE PUBLIKE PËR QARKOREN BUXHETORE 2022/01

I.

Formohen grupet punuese për organizimin e debateve publike, për Qarkoren buxhetore 2022/01.

-Grupi punues për organizimin e debatit publik për Grantin e Shëndetësisë, formohet me këtë përbërje:

1.Agnesa Vokshi (AAK), 2.Shkelqesa Hadergjonaj (PDK), 3.Rejhana Tolaj (LDK), 4.Illir Ferizaj (PSD), 5.Agron Demukaj, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Debati publik mbahet me 07 Qershorë ora 10:00.

-Grupi punues për organizimin e debatit publik për Grantin e Arsimit, formohet me këtë përbërje:

1.Milazim Mushkolaj (AAK), 2.Shkelqim Haxhnikaj(LDK), 3.Kestrim Avdimetaj(PDK), 4.Natyra Kuçi (PSD), 5. Agron Demukaj, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Debati publik mbahet me 07 Qershorë ora 11:00.

-Grupi punues për organizimin e debatit publik me Kryesues të Këshillave të fshatrave, për Qarkoren buxhetore 2022/01, është Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), me këtë përbërje:

1.Haki Shehaj,kryesues i KPF-së me antarët e KPF-së, 2.Valdet Nuraj, 3.Albana Avdiu, 4.Kushtrim Loshaj, 5.Albesa Cacaj, 6.Mon Selmonaj dhe 7. Natyra Kuçi si dhe nga Ekzekutivi, Agron Demukaj, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Debati publik mbahet me 07 Qershorë ora 13:00.

Debati publik me qytetar për Qarkoren buxhetore 2022/01 , i organizuar nga Asambleja Komunale do të mbahet me dt.17 Qershor në ora 11:00.

II.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen:Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe të gjitha organet tjera kompetente komunale.


III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe publikimit në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Kryetari i Komunës, organet kompetente komunale dhe Arhivi.

01.Nr.VI-2
Deçan,dt.31.05.2021



Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj